



10 VJET SHKOLLA E STUDIMEVE POLITIKE

Një dekadë në përgatitjen
e udhëheqësve të ardhshëm

ASP

Cikli i dytë i programit për rritjen e kapaciteteve të alumnëve në fushën e kërkimit dhe advokimit

Në monitorim të politikave vendore

Pesë alumnë të Shkollës patën mundësinë që të rritnin kapacitetet kërkuese si dhe të mbështeteshin financiarisht në hulumtimet e tyre me synim përmirësimin e politikave në nivel vendor. Ky program i dedikuar për alumnët u zbatua për të dytin vit rradhazi nga Akademia e Studimeve Politike në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) në periudhën maj-nëntor 2017.

Alumnët patën mundësi të ndiqnin në terren pranë njësive të reja vendore ecurinë dhe problematikën e hasur në zbatimin e reformës administrativo-territoriale. Duke përballur eksperiencën e tyre profesionale dhe vendosur atë në kontekstin e zhvillimeve të përditshme të njësive të reja vendore, këto punime tentuan të

evidentojnë shembujt pozitivë në njësi të caktuara me qëllim replikimin në njësi të tjera, si dhe të ofrojnë rekomandime konkrete për përmirësimin e praktikave aktuale.

Pas një procesi të hapur aplikimi në muajin maj për të gjithë pjesëtarët e rrjetit alumni, u përzgjedhën pesë propozimet më të mira të alumnëve. Në periudhën në vijim, alumnët përfituan dy trajnime mbi teknikat e kërkimit dhe shkrimit të punimit kërkimor si dhe advokimit. Gjithashtu një mbështetje financiare u vendos në dispozicion të tyre për të zhvilluar kërkimin dhe monitorimin në terren të tematikave të propozuara. Mentorimi i punimeve iu besua znj. Gentiola Madhi, e cila është vetë një prej anëtareve të rrjetit alumni, duke ofruar eksperiencën e saj si kërkuese në nivel ndërkombëtar.

Më konkretisht punimet kërkimore u fokusuan:

- Sfida dhe mundësi për riintegrimin e fëmijëve të kthyer nga emigracioni - Rasti i Bashkisë Gjirokastrë
Punoi Evis Fico, Eksperte e politikave të Punësimit dhe Migracionit
- Funkionimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit të Dhunës në Familje - Rasti në Bashkinë Korçë dhe në Bashkinë Berat
Punoi Artur Hasanbelliu, Drejtor, Drejtorja e Auditimit të Brendshëm, Kontrolli i Lartë i Shtetit
- Nga përfaqësimi formal i grave drejt influencimit efektiv në politikat vendore - Rasti i Bashkisë Shkodër
Punoi Gentiana Ramadani, Kandidate Ph.D. pranë Universitetit të Vjenës
- Potenciali i demokracisë direkte në mirëqeverisjen vendore - Rasti i Bashkisë



Funksionimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit të Dhunës në Familje

Autor z. Artur Hasanbelliu

● **Roli i Njësive të Qeverisjes Vendore është thelbësor** në mirëfunksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit të Dhunës në Familje. Rastet e bashkisë Korçë dhe Berat, dëshmojnë se nevojitet të shfrytëzohet ky potencial dhe të mos neglizhohet krijimi i komiteteve dhe strukturave të tjera ndërinstitucionale vendore;

● Drejtorja e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shën-

detësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet të shfrytëzojë **mekanizmat ligjorë për të ushtruar presion mbi Njësitë e Qeverisjes Vendore**, të cilat kanë neglizhuar detyrat që lindin për to nga Mekanizmi Kombëtar i Referimit;

● Rekomandohen ndryshimet ligjore që bëjnë të mundur **përsheptimin e procedurave ligjore** dhe përcaktimi i afateve të qarta për kërkesat e "urdhrit të mbrojtjes" për gratë viktime të dhunës në familje.



Nga përfaqësimi formal i grave drejt influencimit efektiv në politikat vendore

Autore znj. Gentiana Ramadani

● Bashkia Shkodër së bashku me

njësitë administrative të qarkut rekomandohet që të mundësojnë **ndërhyrje në nivele informuese** rreth rëndësisë së pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në proceset konsultative për hartimin e politikave lokale;

● **Rekomandohet ngritja e 'Jurive' të qytetarëve** në përbërje ekuilibruese gjinore, të cilët sigurojnë të dhëna dhe informacione për procesin e hartimit të politikave lokale. Kjo juri mund të njohë në kompozimin e saj afërsisht rreth 25 qytetarë të përzgjedhur në mënyrë rastësore dhe që angazhohen të takohen periodikisht. Këto juri shërbejnë për të integruar në procese diskutimesh të gjera dhe shkëmbim informacionesh dhe opinionesh. Kjo është një praktikë e vjetër në Gjermani, qysh në vitin 1970 dhe njihet si model i sukseshëm;

● **Rekomandohet krijimi i forumit**



Prezantimi i punimit "Sfida dhe mundësi për riintegrimin e fëmijëve të kthyer nga emigracioni"

Tiranë
Punoi Indrit Puteci, Këshilltar i Kryetarit,
Bashkia Tiranë
• Mangësitë në përdorimin e mediave

sociale nga ana e bashkive - Analizë e
bashkisë Sarandë dhe bashkisë Mat
Punoi Alban Tartari, Universiteti i Tiranës,
Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit

**Prezantimi i punimit mbi
fëmijët emigrantë**

Punimet kërkimore të alumnëve synohet

të gruas në çdo njësi administrative.
Këto forume angazhohen posaçërisht
vetëm në çështjet dhe përditshmërinë
e grave dhe vajzave, problemet që ato
kane dhe mënyrat si mund të zgjidhen.
Këto forume mund të menaxhohen nga
nëpunësi i barazisë gjinore, i cili kryen
funksionin e tij pranë sektorit të shërbi-
mit social në bashki.



**Potenciali i
demokracisë
direkte në
mirëqeverisjen
vendore**

Autor z. Indrit Puteci

● Në mënyrë që koncepti i demokracisë
direkte të pranohet e përqafohet nga
qytetarët e Tiranës, si për çdo koncept

të ri, është e nevojshme paraprakisht një
**fushatë sensibilizimi përmes takimeve
të drejtpërdrejta** dhe përdorimit të të
gjithë elementëve të mundshëm për
sensibilizimin dhe informimin;
● Duke qenë se mungon baza ligjore
për ta bërë 'të detyrueshëm' aplikimin
e demokracisë direkte rekomandohet
të përzgjidhen një ose dy njësi admin-
istrative të Bashkisë së Tiranës për t'u
konsideruar si **njësi pilot**. Për të mbuluar
më mirë tipologjinë e Bashkisë së Tiranës
dhe mundësuar zbatimin e demokracisë
direkte do të ishte e nevojshme që një
njësi administrative të përzgjidhej nga
ato njësi që i përkasin hapësirës urbane
të Tiranës dhe një nga ato njësi që i
përkasin hapësirës rurale të saj;
● Rekomandohet që e drejta e të
shprehurit të vullnetit të banorëve të
Bashkisë së Tiranës të mundësohet në

formë sa më komode për ta. Për këtë
shihet si zgjidhje optimale **zhvillimi i
një software/aplikacioni që mundëson
votimin elektronik** në rastin që iniciati-
va e një grupi qytetarësh shkon deri në
referendum.



**Mangësitë dhe
problemet në
përdorimin e
mediave
sociale nga ana e
bashkive**

Autor z. Alban Tartari

● Më shumë vëmendje në çështjet e
komunikimeve të reja publike. Njësitë e
Qeverisjes Vendore kanë detyrimin për
të komunikuar me qytetarët më shumë
se cdo institucion tjetër publik. Për këtë
arsye, nevojitet që ato t'i kushtojnë një

të prezantohen në aktivitete publike apo advokuese me pjesëmarrjen e vendim-marrësve dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm. Gjetjet e njërit prej këtyre punimeve, i titulluar “Sfida dhe mundësi për riintegrimin e fëmijëve të kthyer nga emigracioni” me fokus bashkinë Gjirokastrë, u diskutuan në një tryezë të rrumbullakët me ekspertë, alumnë si dhe përfaqësues të organizatave partnere, me qëllim nxitjen e një dialogu publik gjithpërfshirës mbi problematikat dhe gjetjen e zgjidhjeve. Znj. Evis Fico, eksperte e politikave të Punësimit dhe Migracionit, paraqiti disa prej rekomandimeve, të cilat konsistojnë në:

- Mungon dhe nevojitet të hartohet një strategji afatgjatë për riintegrimin dhe mbi politikat riintegruuese që marrin në konsideratë nevojat e migrantëve, por edhe të komuniteteve;
- Rekomandohet ndryshimi i sistemit aktual të referimit dhe shkëmbimit reciprok të informacionit ndërmjet Sporteve të Migracionit dhe institucioneve qendrore;
- Nevojitet të hartohet një raport vlerësues nga Ministria e Arsimit mbi situatën e fëmijëve emigrantë të kthyer dhe shër-



Punimet e botuara me qëllim shpërndarjen e tyre me aktorët kryesorë.

bimet e ofruara pas përfundimit të orarit të mësimin për të ndihmuar përfshirjen dhe integrimin e tyre gjuhësor e social.

Drejtoresha e Shërbimit Social Shtetëror në Gjirokastrë, znj. Magdalena Margariti, vlerësoi punimin dhe u zotua për përfshirjen e tij në dokumentat për hartimin e planit të veprimit për vitin e ardhshëm. Gjithashtu, ajo dhe aktorët e tjerë rekomanduan shtrirjen e mëtejshme të kërkimit në njësitë e tjera vendore që për-

ballen me sfidën e kthimit të emigrantëve dhe problematikën e riintegritmit të tyre.

Punimet e tjera të prodhuara nga ky program do të prezantohet gjithashtu në aktivitete me aktorët dhe vendim-marrësit e ndryshëm. Gjithashtu, një set me punimet u printua në formatin e një publikimi, me qëllim dërgimin e tij pranë drejtuesve të institucioneve të linjës si dhe promovimit të mëtejshëm të tyre nëpërmjet kanaleve të komunitit të Akademisë.

vëmendje të veçantë komunikimeve të reja publike si dhe të alokojnë burime financiare për këtë fushë;

● Më shumë burime njerëzore të kualifikuara. Rekomandohet shtim i stafit në fushën e MP dhe kualifikim i vazhdueshëm në teknikat e komunikimeve të reja. Nuk shohim në këto faqe teknika të reja komunikuese siç janë hashtag-et, siç për shembull: #VizitoSaranden #EjaNeMat etj. Këto faqe kërkojnë

buxhete që të promovohen, që të blihen përmbajtje cilësore për të promovuar zonën. Për shembull Bashkia e Sarandës mund të ndërtojë edhe komunikime dhe informacione në gjuhë të huaja për të tërhequr sa më shumë vizitorë të huaj. Po ashtu Bashkia e Matit, e cila zotëron disa pika turistike dhe historike, mund të tërheqë vizitorë fillimisht nga brenda vendit e më tej pse jo edhe nga zona të tjera;

● Më shumë standarde etike. Etika në faqet në rrjetet sociale është shumë e rëndësishme. Sa më i polarizuar, i njëanshëm dhe i ndikuar politikisht apo personalisht të jetë komunikimi i këtyre institucioneve, po aq i polarizuar dhe jo etik do të jetë edhe komunikimi i publikëve. Për këtë arsye rekomandohet që të ketë një ndarje të qartë në komunikimin e NJQV nga ndikimi politik apo biznesi.

ASP lehtëson përfshirjen e alumnëve në konsultimet mbi reformat e rëndësishme

Kontribut në reformën zgjedhore dhe strategjinë e Administratës Publike

Rrjeti i alumnëve të Shkollës ka krijuar tashmë besimin e duhur për t'u përfshirë në proceset e konsultimeve të institucioneve kryesore. Falë kësaj eksperience, Akademia e Studimeve Politike u ftua zyrtarisht nga komisioni i posaçëm parlamentar i reformës zgjedhore si dhe Departamenti i Administratës Publike (DAP) për të ofruar komente dhe rekomandime mbi reformat e ndërmarra prej tyre.

Më konkretisht, ASP dorëzoi zyrtarisht në muajin mars 2018 një dokument rekomandues pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore me qëllim përmirësimin e procesit të administrimit zgjedhor. Dokumenti u dorëzua në vijim të zhvillimit të një seance dëgjimore në Kuvend, ku ASP u përfaqësua nga alumna znj. Evis Fico.

Disa nga rekomandimet kryesore mbi procesin e administrimit zgjedhor ishin:

1. Ngritja e një Qendre Trajnimi pranë KQZ me qëllim rritjen e profesionalizmit të trupës zgjedhore. Kjo duhet shoqëruar me rregullime ligjore për të kthyer certifikimin nga kjo qendër si kusht për t'u regjistruar si komisioner në zgjedhje.
 2. Rregullime të nevojshme ligjore për të përcaktuar qartësisht institucionet, të cilat duhet të ndjekin ankesat për shkeljen e së drejtës së votimit si dhe ndëshkimin për abuzimet me votën.
 3. Përdorimi i teknologjisë së informacionit për të rritur informimin si dhe ofruar një mundësi të mëtijshme për të raportuar presionet dhe abuzimet me votën.
- ASP do të vazhdojë të ndjekë nga afër punën e Komisionit të Posaçëm Parlam-



entar për Reformën Zgjedhore si dhe të ofrojë ekspertizën e saj me synim finalizimin e një reforme tepër të rëndësishme për vendin.

Gjithashtu, në muajin prill 2018, ASP u ftua nga grupi i punës pranë Kryeministrit në konsultimet mbi Planin e Veprimit 2018-2020 të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike. Falë komenteve të ofruara nga alumna,



Znj. Eralda Methasani Çani

znj. Eralda Methasani Çani, ASP përgatiti dhe dorëzoi një dokument me 13 rekomandime mbi planin e veprimit, të cilat u vlerësuan me interes nga grupi i punës. Drejtoresha e Departamentit të Administratës Publike (DAP) znj. Albana Koçiu, vlerësoi rekomandimet e dorëzuara dhe u zotua për reflektimin e disa prej sugjerimeve në versionin final të Planit të Veprimit.

Krijimi i një Administrate Publike profesionale dhe të aftë për t'ju përgjigjur sfidave aktuale mbetet një nga kushtet kryesore për integrimin evropian të vendit. Kontributi mbi strategjinë e Administratës Publike është në një linjë me zhvillimin e kapaciteteve të ASP për të ofruar trajnime për rritjen e kapaciteteve të administratës publike, në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike (ASP) dhe Qendrën e Ekspertizës së Këshillit të Evropës.

Një dekadë në përgatitjen e udhëheqësve të ardhshëm

Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike shënoi 10 vjet nga nisja e aktivitetit të saj për përgatitjen e brezit të ardhshëm të udhëheqësve politikë, ekonomikë dhe socialë në vend. Ky përvjetor i rëndësishëm u kremtua në një ceremoni të zhvilluar më 5 dhjetor 2017 në hotel Plaza në Tiranë. Personalitete të rëndësishme si Presidenti i Republikës z. Ilir Meta; zv.kryeministria znj. Senida Mesi; kreu i zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Z. Claus Neukirch; ambasadori zviceran në Tiranë, Z. Christoph Graf, si dhe bashkëpunëtorë të ndryshëm ndër vite, vlerësuan rolin Shkollës së ngritur nga Këshilli i Evropës për edukimin e udhëheqësve të rinj. Programi i Shkollës vazhdon të mbetet unik në formatin e tij duke ulur së bashku përfaqësues të forcave të ndryshme politike, por edhe vendimmarrësit kryesorë, të zgjedhurit vendorë dhe aktivistët e shoqërisë civile dhe medias, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave, lehtësimin e dialogut dhe gjenerimin e ideve të reja. Eventi u nderua edhe nga prezenca e dy ish-presidentëve z.Rexhep Meidani dhe z.Alfred Moisiu si dhe personalitete të tjera të politikës dhe profesionistë të njohur, të cilët kanë shërbyer si lektorë ndër vite në kurset e Shkollës.

Vlerësimet për Shkollën

Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta u shpreh në fjalën e tij: Përshëndes për zemërsisht veprimtarinë e Shkollës së Studimeve Politike, si një mundësi shumë e mirë që u ofrohet të rinjve shqiptarë të spikatin në individualitetin e tyre, si drejtues të të ardhmes dhe për të marrë më shumë përgjegjësi". Zoti Meta këshilloi

gjithashtu pjesëmarrësit e Shkollës që të jenë sa më të angazhuar: Sillni në Shqipëri ndryshimin përmes veprimit, dhe më e rëndësishmja, merrni përgjegjësi për të ardhmen e vendit dhe të vetes!

Zv.kryeministria znj. Senida Mesi, nënvizoi në fjalën e saj faktin që ajo është njëra prej ish-pjesëmarrëseve të Shkollës në vitin 2016. "Tradita e krijuar e sistemit të vlerave nëpërmjet kësaj shkolle ka shërbyer, shërben dhe do të shërbejë përherë si një bazë solide e tejet vizionare në promovimin dhe ngritjen e liderëve të së ardhmes. Qeveria Shqiptare, do të jetë përherë një partnere e denjë dhe mbështetëse e programeve të tilla ambicioze studimore, të cilat i shërbejnë të gjithëve në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë." u shpreh znj. Mesi.

Ambasadori i Zvicrës z.Christoph Graf nënvizoi: "Me diplomimin nga kjo Shkollë ju merrni gjithashtu përgjegjësinë për të çuar më tej ndryshimet dhe reformat për të cilat ka nevojë ky vend. Ju jeni pararendësit e vlerave demokratike në Shqipëri. Bëhuni një model pozitiv për të sjellë ndryshimet e duhura. Bëhuni fytyra dhe zëri i një fryme përparimtare dhe demokratike, e cila e udhëheq Shqipërinë në një fazë të re të ecurisë së saj", përfundoi ambasadori Graf.

Z. Claus Neukirch, nga Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë, vlerësoi alumnit e shkollës si një rrjet që mund të sjellë ndryshimin e prituri. "Jemi të lumtur të shikojmë arritjet e kësaj Shkolle në forcimin e vlerave demokratike në Shqipëri dhe krijimin e një terreni pjellor për dialog dhe



bashkëpunim midis të rinjve që vijnë nga bindje politike të ndryshme". Z. Neukirch theksoi vëmendjen që i kushton Këshilli i Evropës rrjetit të Shkollave dhe u zotua për vazhdim të mëtejshëm të mbështetjes për këtë program.

Gjurmët e një dekade

Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike u ngrit në Shqipëri në vitin 2007 nga Këshilli i Evropës si pjesë e një rrjeti të gjerë të shkollave në 21 vende të ndryshme anëtare të kësaj organizate. Zbatimi i programit iu besua dy vite më pas Akademisë së Studimeve Politike (ASP), duke përfutur nga zhvillimi strategjik i Këshillit të Evropës për funksionimin dhe përmbajtjen e kurrikulave, por dhe eksperiencës së një stafi shqiptar për të koordinuar më mirë tematikat dhe lektorët sipas aktualitetit



Fjala në ceremoni e drejtorit të ASP

Demokracia nuk është e sigurtë pa angazhim



"...Nëse kthejme kokën pas në këto dhjetë vite të ekzistencës së Shkollës ka shumë arritje dhe zhvillime pozitive. Politika dhe shoqëria shqiptare është bërë më e hapur dhe më gjithëpërfshirëse. Por zhvillimet e fundit globale si ulja e besimit në institucionet politike, rritja e valës së populizmit dhe forcave autoritare edhe në demokracitë më solide, të gjitha këto na dëshmojnë se demokracia dhe qeverisja e mirë nuk mund të merren asnjëherë për të mirëqëna pa një shoqëri të angazhuar, pa të rinj të përgatitur dhe aktivë për të qënë gardianë të vlerave demokratike. E pikërisht në këto momente, kontributi dhe angazhimi i çdo qytetari dhe profesionisti për të dhënë një përgjigje ndaj këtyre rreziqeve është edhe më i domosdoshëm. Programi i Shkollës dhe angazhimi i mëtijshëm në rrjetin alumni, ofron mundësinë e duhur për të nxitur reagimin e shoqërisë ndaj këtyre sfidave. Të gjithë pjesëmarrësit e Shkollës gjatë këtyre dhjetë viteve kanë dëshmuar se dëshirojnë të jenë mbrojtës të këtyre vlerave demokratike. Duke rritur njohuritë personale në aspektet e organizimit të shtetit dhe mirëqeverisjes, duke ofruar ekspertizën profesionale për monitorimin e reformave të ndryshme, ata kanë kontribuar në forcimin e demokracisë dhe për të përmirësuar të ardhmen e vendit..."

kombëtar.

Brenda pak vitesh programi krijoi reputacionin dhe besimin e duhur për të patur rritjen e vazhdueshme të numrit dhe cilësisë së aplikantëve si dhe profesionalizmit të lektorëve më të mirëvendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë u rrit edhe fusha dhe numri i programeve të zbatuara nga ASP, duke krijuar mundësi të mëtijshme për angazhimin e pjesëmarrësve të Shkollës në fusha të tjera si pushteti vendor, zgjedhjet, energjia dhe mjedisi etj. Ambasada zvicerane është mbështetësi kryesor i programit që prej vitin 2012 duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve të vetë stafit të Shkollës si dhe në zbatimin e programeve të tjera që kanë në qendër të tyre ish-pjesëmarrësit (alumnët). Shkolla krenohet sot me dhjetë gjeneratat e pjesëmarrësve të saj (mbi 300 anëtarë),

të cilët ofrojnë eksperiencën e tyre profesionale në reformat kryesore në vend si dhe veprojnë si përcjellës të vlerave demokratike të pluralizmit, diversitetit dhe dialogut të hapur në fushat e tyre respektive.

Që nga themelimi mund të numërohen se janë organizuar më shumë se 80 trajnime / kurse për ngritjen e kapaciteteve, 150 seminare tematike dhe 10 konferenca në nivel kombëtar e rajonal. Falë kontributit të pjesëmarrësve dhe ekspertëve të ndryshëm janë prodhuar më shumë se 80 dokumente të politikave dhe 16 publikime të tjera më fokus mirëqeverisjen. Njëkohësisht, janë rritur gjatë viteve kapacitetet institucionale dhe organizative të Akademisë së Studimeve Politike, me qëllim përfshirjen e potencialeve profesionale të rrjetit alumninë proceset reformuese.



Alumnët, një rrjet vlerash

VITI 2007

EMRI	POZICIONI *
Z. Alban Tartari	Zëvendëskryeredaktor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Z. Albert Faruku	Deputet
Z. Alfred Gega	Deputet
Z. Andi Krraqi	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Demokratiane
Z. Arben Haveri	Drejtor i NBG Bank në Shkodër
Z. Arben Lagreta	Gazetar
Z. Arben Porocani	Ass. Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Z. Arben Shkodra	Drejtor i Administratës dhe Shërbimeve, Këshilli i Ministrave
Znj. Arbëresha Mushani	Mësues
Znj. Ardiana Kasa	Menaxhere Programi, organizata "Eorld Vision"
Z. Artemon Cukalla	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Aleanca Demokratike
Z. Artur Hasanbelliu	Deputet

Z. Artur Kopani	Drejtor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Znj. Blerina Balilaj	Specialiste pranë Institutit Demokratik Kombëtar - NDI
Znj. Blerina Tepelena	Kreu i sektorit të monitorimit të strategjisë për komunitetin Rom
Znj. Elga Mitre	Specialiste pranë ambasadës holandeze në Tiranë
Znj. Elma Teršana (Shehu)	Drejtoresh e Programit për mbikëqyrjen e të drejtave të Fëmijëve (UNICEF)
Z. Elton Halimi	Pedagog në Fakultetin e Shkencave, Universiteti i Tiranës
Z. Endri Jorgoni	Këshilltar, Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
Z. Erjon Meta	Analist pranë misionit policor ICITAP
Znj. Ersejla Murati	Gazetare, "Koha" TV
Z. Gramos Qendro	Specialist në Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit

Znj. Iva Hyseni	Juriste, Drejtoresha e Studimeve, Publikimeve dhe Informacionit në Gjykatën e Lartë
Znj. Kimete Klenja	Koordinatorë programesh pranë organizatës UNIFEM
Z. Kostandin Kazanxhi	Jurist
Z. Ledion Kola	Asistent shërbimi ndaj klientit (ABA)
Znj. Lindita Luzo	Koordinator Projekti në PNUD
Znj. Sida Gipali	Konsulente lokale për Ministrinë e Shëndetësisë
Z. Teki Kurti	Kryetari i Këshillit të Komunës Martanesh

VITI 2008

Znj. Arbana Dibra	Drejtoresh ekzekutive e zyrës së OSBE-së në Shkodër
Z. Arben Vata	Kryeredaktor, "Ora Neës" TV
Znj. Beslinda Rugia	Asistent avokate

Z.	Bledar Kurti	Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Znj.	Brasena Koka	Koordinatorë projekti pranë organizatës "Eorld Vision"
Znj.	Brunilda Minaroli (Peci)	Specialist në departamentin për marrëdhëniet ndërkombëtare, Ministria e Jashtme
Znj.	Edlira Gjoni	Koordinatorë projektit EU-CARDS VET të tinning / Gazetare
Znj.	Edlira Mali	Drejtor Ekzekutiv e degës së kompanisë "Ogilvy" në Tiranë
Znj.	Edlira Papavangjeli	Koordinatorë Programi pranë organizatës Komiteti i Helsinkit
Znj.	Elda Zotaj	Asistente Administrative në Universitetin e Tiranës
Z.	Elson Thana	Oficer i Policisë Gjyqësore
Znj.	Elvana Zhezha	Shef i Kabinetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme
Znj.	Eralda Cani Methasani	Lektore në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Z.	Erion Avllazagai	Lektor në Universitetin e Elbasanit
Z.	Erjon Tase	Analist Politik në "Gazeta Shqiptare"
Z.	Erlis Cela	Gazetar në gazetën "Standard"
Z.	ERVIN KARAMUCO	Zëvendëskomisioner pranë "Avokatit të Popullit"
Znj.	EVIS FICO	Shef i Sektorit për Emigrimin në Shërbimin Kombëtar të Punësimit
Z.	FLIR MOSHO	Drejtor i Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Financave
Znj.	GENTIANA RAMADANI	Drejtorë ekzekutive e organizatës "Gratë për gratë"
Z.	GJERGJI TANE	Drejtor i Zyrës lokale të punësimit në Korçë
Z.	GJOK VUKSANI	Deputet
Znj.	IVIS NOCKA	Shef në Sektorin e Monitorimit, Ministria e Mbrojtjes

Z.	KLODIAN RJEPAJ	Koordinator Kombëtar në Institutin e Shëndetit Publik
Znj.	KLODIANA GJINAJ	Këshilltare për mediat pranë KESH
Z.	MARIN MEMA	Gazetar "Top Channel"
Znj.	MONIKA STAFJA	Gazetare "Top Channel"
Znj.	NAHLEL BEJLERI – FICO	Inspektore në Shërbimin Social Shtetëror
Z.	OLSI KARAPICI	Drejtor i Departamentit të IT në Këshillin e Ministrave
Z.	REMZI ALIAJ	Drejtor rajonal i Shërbimit Social Shtetëror
Z.	REZART LAHI	Drejtori i Përgjithshëm i "Shijak TV"
Znj.	SANIJE FATKOJA HAXHIHYSENI	Menaxhere dege e "Opportunity Albania"
Znj.	VILMA PREMTI	Drejtorë në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

VITI 2009

Z.	Adrian SHEGA	Asistent avokat, Shërbimi ligjor falas Tiranë
Znj.	Admira Poci	Specialiste pranë Institutit Goethe
Znj.	Albana HANA	Specialiste në Ministrinë e Integrimit
Znj.	Ana XHEKA	Drejtorë në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
Znj.	Ardita SHEHAJ	Shef departamenti, Autoriteti i Konkurrencës
Znj.	Beti NJUMA	Gazetare, "Top Channel"
Z.	Blerim KOLA	Kryeredaktor, Nesër TV
Z.	Edvin SHVARC	Drejtor i Informacionit Publik dhe Protokollit pranë Presidentit të Republikës
Znj.	Elira CANGA	Gazetare, "Gazeta Shqiptare"
Znj.	Elsa TOSKA (DOBJANI)	Këshilltare Ligjore në Gjykatën Kushtetuese
Znj.	Entela HAMITI	Anëtare e Partisë Socialiste
Znj.	Erinda SHAH	Anëtare e Partisë G99

Z.	Ermal GJINAJ	Kreu i departamentit të marrëdhënieve publike në Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjisë
Z.	Eugen Pepa	Këshilltar Ligjor në Parlamentin Shqiptar
Z.	Genc HOXHA	Supervizor i Shërbimit të Rrjetit, Vodafone Albania
Z.	Gentian ISLAMI	Drejtor i Planifikimit Urban, Bashkia Kuçovë
Z.	Gentian MANO	Menaxher i organizatës "Eorld Vision", Librazhd
Znj.	Gerta META	Drejtorë Ekzekutivë e Shoqërisë për Kulturë Demokratike (SHKD)
Z.	Hysni AHMETAJ	Specialist në Ministrinë e Integrimit
Z.	Ilir TOPI	Aktivisti i Forumit Rinor të Partisë Demokratike
Znj.	Ingrit PRIZRENI	Shtëpia Botuese "Media Print"
Znj.	Liliana ALIMETA	Shef për kontratat dhe procedurat për donatorët, Ministria e Financave
Znj.	Mimoza KOCIU	Këshilltare për median, zëdhënëse e zyrës së Presidentit të Republikës
Z.	Plarent RUKA	Këshilltar Ligjor, Ministria e Shëndetësisë
Znj.	Plejada GUGASHI	Menaxhere Programi për OLOF Palm International Center Albania
Z.	Redi BADUNI	Kreu i Sekretariatit të Rinisë në Partinë Republikane
Z.	Redi SKENDERAJ	Gazetar, Koha TV
Znj.	Rezarta GODO	Programi "Brain Gain", PNUD
Znj.	Sonila MECO	Gazetare, Klan TV
Z.	Urim BAJRAMI	Kryeredaktor i Gazetës "Shqip"

VITI 2010

Z.	Afrim Kola	Shef i Kontrollit Ajror në Forcat Ajrore Shqiptare
Z.	Alban Fishka	Specialist në Inspektoriatin Teknik Qendror
Znj.	Aleksandra Bogdani	Kryeredaktore në "Top Neës" TV

RRJETI ALUMNI 2007-2017

Znj. Anila Shqypi	Koordinatorë projekt, GTZ Albania
Z. Arber Kadia	Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare në Tiranë
Z. Besjan Pasha	Këshilltar i kryetarit, zëvendës-sekretar i Përgjithshëm i LSI
Z. Bilbil Keraj	Shef i kabinetit në Bashkinë e Kukës
Znj. Blerta Gjermani	Kryeredaktore, ORA Neës TV
Z. Dritan Nushi	Zyra e Prokurorit, Rrethi Kavajë
Znj. Egllantina Bisha	Specialiste pranë Qendrës së biznesit "Eurocol"
Z. Elton Lula	Menaxher Projekti pranë Shërbimit Ligjor falas në Tiranë
Znj. Enina Mullaj	Specialiste në departamenti ligjor në Parlamentin Shqiptar
Z. Enkes Shundi	Këshilltar, Shef i Protokolit të Presidentit të Republikës
Z. Evarist Beqiri	Specialist ligjor pranë Shërbimit Informativ Shtetëror
Znj. Fatjona Mejdini	Gazetare, "Shqip"
Z. Fjorel Como	Specialist në Ministrinë e Transportit/aktivist në Forumin Rinor të PD-së në qytetin e Gjirokastrës
Z. Genard Kastrati	Drejtor Ekzekutiv në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve
Znj. Giomela Gjini	Drejtor Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave
Z. Ilir Paco	Gazetar "Top Channel"
Znj. Irena Kita (Dimushi)	Specialiste ligjore në Bankën Credins
Znj. Jonida Shehu	Gazetare në "Vizion Plus" TV
Znj. Karolina Risto	Kryeredaktore e Vizion Plus TV
Znj. Klodiana Thartori	Koordinatorë Programi "Save the Children"
Z. Klodjan Seferaj	Këshilltar në Këshillin e Ministrave



Znj. Klotilda Neziri	Shef kabineti në bashkinë e Pogradecit
Z. Ledio Milkani	Këshilltar Ligjor për Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë
Znj. Migena Muhaj	Koordinatorë në programin Seiss Partnerships in Health
Znj. Migena Nelaj	Drejtorë për median dhe marrëdhënien me publikun pranë KESH
Z. Ols Lafi	Drejtor në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Znj. Oriana Arapi	Koordinator për Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integrimin në Këshillin e Ministrave
Z. Qemal Cejku	Shef kabineti në Bashkinë e Kamzës
Znj. Rozana Celmeta	Kreu i Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave
Z. Saimir Shatku	Këshilltar ligjor për administrimin në Këshillin Bashkiak të Tiranës
Znj. Suela Cela	Specialiste në departamenti ligjor në Ministrinë e Bujqësisë

VITI 2011

Znj. Ada Ramaj	Ndihmëse e zv.ministrit të Brendshëm
Znj. Albana Veizi	Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Presidentit të Republikës
Z. Alvi Bajramaj	Specialist i Marrëdhënieve Publike, QSUT
Znj. Anxhela Andoni	Aktiviste e Forumit të Gruas të Partisë Socialiste, rrethi Pogradec
Z. Arlind Lugji	Specialist në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive
Z. Arnold Hajro	Jurist vendor pranë Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO)
Znj. Daniela Mehmeti	Juriste pranë Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës
Znj. Enila Hasani	Shefe në Departamentin e Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Brendshme
Z. Enio Haxhimihali	Shef kabineti në Këshillin Kombëtar të Radio-Televizionit
Znj. Erjola Muka	Kreu i Sektorit të Politikave të Mjedisit, Bashkia Tiranë



Z. Genti Çani Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes së Pronës Intelektuale, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Z. Gentian Xhaxhiu Gazetar "Shijak TV"

Znj. Gresa MARTIRI Juriste pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë

Z. Helidon BELE Drejtor në Tirana Bank

Z. Ilir Stojku Specialist në Sektorin e Koordinimit, Ministria e Drejtësisë

Znj. Klesta Hysi Koordinatore programi pranë organizatës "Fëmijët Sot"

Z. Kreshnik Ternova Administrator, ALK Pharma sh.p.k.

Znj. Ledi Jahja-Muça Administratore pranë organizatës SNV në Shqipëri

Znj. Merita Mansaku-Meksi Oficer Programi, Zyra Austriake për Zhvillim

Znj. Mirjam Reçi Drejtore ekzekutive pranë organizatës CSDC Durrës

Znj. Olta Blaceri Kryeredaktore e programit "Ora e debatit" në "Ora Neës" TV

Z. Qamil Dika Kreu i Këshillit Studentor Kombëtar / Aktivist i PD

Znj. Rajmonda Lajthia Gazetare, "Vizion Plus" TV

VITI 2012

Znj. Albana Shtylla Shefe kabineti në Zyrën e Avokatit të Popullit/ Anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Znj. Alisa Demollari Zëdhënëse/Ministria e Shëndetësisë

Z. Altin Hoti Lektor i Ekonomisë Ndërkombëtare në Universitetin Mesdhetar/ Universitetin Evropian

Z. Altin Ibro Jurist/ Celibashi Consulting shpk

Z. Andi Seferi Drejtues i Komunitetit të Sant'Edigio në Shqipëri

Znj. Anisa Seferaj Juriste/ Bashkia Tiranë

Znj. Ardita Kongjonaj Specialiste në Agjencinë Kombëtare për Ekzaminimin, Ministria e Arsimit

Z. Arian Galdini Kryetar i FDE, Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë / Lektor pranë Universitetit Luarasi

Znj. Baisa Sefa Kërkuuese pranë organizatës Lëvizja Evropiane në Shqipëri

Z. Elidon Laze Drejtor në Drejtorinë e Ligjore dhe të Apelit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme

Z. Erlis Shahu Specialist IT pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Z. Ermal Simaku Doktor / Anëtar i Forumit Rinor të Partisë Socialiste

Z. Ermir Godaj Shërbimi i Përmbartimit, Ministria e Drejtësisë

Znj. Ervina Domi Drejtor në Departamentin Ligjor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Znj. Eva Dauti Juriste, Shoqata Shqiptare e Bashkive

Znj. Florensa Haxhi Koordinator e strategjive në Këshillin e Ministrave

Z. Fredi Guga Drejtor i Qendrës së Shëndetit në Durrës/ Koordinator projekti në "Europartners Development"

Z. Ilir Kondi Drejtor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare / Aktivist i Partisë Demokratike (PD)

Z. Ilir Korbi Jurist në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme

Z. Ilir Mimani Specialist në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore

Znj. Jorina Gjinar Menaxher Projekti tek Qendra e Studimeve Future

Z. Ledio Braho Jurist në Ministrinë e Integritetit/Asistent profesor në Universitetin e Tiranës

Znj. Margarita Kola Specialiste ligjore në Ambasadën Amerikane / Aktiviste e partisë politike Aleanca KuqeZi (AK)

Znj. Mariola Qesaraku Koordinator projekti pranë Instituti për Demokraci dhe Meditim

Znj. Marsida Çela Menaxher Programi tek Qendra e Fëmijëve SOT/ Menaxhere në agjencinë e Shërbimeve sociale GC, NY, SHBA

RRJETI ALUMNI 2007-2017

Znj. Merita Osmani (Muçaj)	Juriste në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës/Lektore në Universitetin Amerikan të Tiranës
Znj. Mirela Karapici	Drejtor Marketingu dhe i Marrëdhënieve me Publikun në Postën Shqiptare
Z. Oltion Kuke	Drejtoreshë Departamenti në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave
Z. Rezart Xhelo	Specialist pranë misionit të OSBE
Znj. Romina Kuko	Asistent Projekti, OSBE
Znj. Rovena Rojba	Inspektor Vlerësimi në Drejtorinë Rajonale të Taksave, Tiranë
Z. Sokol Bega	Asistent politik, OSBE
Znj. Suela Lala	Aktiviste në Shoqërinë Civile



VITI 2013

Znj. Albana Hasanaj	Specialiste në Agjencinë e Zhvillimit të Investimeve në Shqipëri (AIDA)
Znj. Amela Zaganjori	Arsimtare/Aktiviste në Partinë Demokratike (PD)
Z. Armand Metani	Menaxher i Përgjithshëm i Milifar sh.p.k.
Z. Arti Cicolli	Drejtor i IT-së në Presidencë
Z. Basir Collaku	Këshilltar dhe Zëdhënës i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave
Znj. Blerina Doracaj	Eksperte ligjore dhe prokurimesh në Agjensinë e Zhvillimit të Zonave Malore / Aktiviste në Partinë Socialiste (PS)
Znj. Edlira Nasi	Specialiste në kompaninë Antea Cement / Aktiviste e të drejtave civile dhe të minoriteteve
Znj. Elda Gjoka	Themeluese dhe drejtuese e kompanisë Genuine Effect
Znj. Eneida Ahmeti	Avokate tek firma ligjore Shala/Aktiviste në partinë politike Aleanca Kuqezi (AK)

Znj. Enkeleda Basha	Asistente në Gjykatën e Rrethit Shkodër/Aktiviste e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim
Z. Erand Nebo	Departamenti i Leasing, Banka Societe General
Znj. Ervis Rahmani	Lektor në Universitetin Kristal/Specialist në Ministrinë e Integrimit/Aktiviste në Partinë Socialiste
Z. Fatmir Konja	Asistent në Zyrën e Presidentit të Republikës
Znj. Florenca Korbi	Menaxhere Projekti në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë
Z. Jonito Bregasi	Kontrollor i Trafikut Ajror/ Aktivist në Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)
Z. Jugert Jorgo	Nëpunës në Departamentin e Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme
Z. Julian Llupo	Specialist në Autoritetin e Konkurrencës
Znj. Klementina Cenckollari	Gazetare, "Ora Neës" TV
Z. Oltion Pengu	Konsulent Lokal në Këshillin e Ministrave

Znj. Sabina Juka	Eksperte në Këshillin e Ministrave
Znj. Sentiljana Barzezi	Specialist tek CEZ/Aktiviste e partisë politike Fryma e Re Demokratike (FRD)
Znj. Valbona Lasku	Menaxhere Zyre në BCC Tirana

VITI 2014

Znj. Alma Binaj	Asistente pranë zyrës të deputetit Edi Rama në Vlorë
Znj. Anisa Xhafa	Specialiste e marrëdhënieve publike pranë GIZ Albania/ Aktiviste e partisë FRD
Znj. Arsela Gjonaj	Specialiste pranë Këshillit Bashkiak Tiranë / Lektore në universitetin e Beratit
Z. Dritan Cekani	Nëndrejtor i Përgjithshëm i Doganave / Aktivist i Partisë Socialiste
Z. Elidon Lamani	Menaxher projektsh pranë organizatës "Qendra Rinore e Vlorës"/ Aktivist i shoqërisë civile
Z. Endri Mykaj	Këshilltar ligjor pranë Këshillit të Ministrave



Znj. Enisa Halili	Specialiste pranë drejtorisë së Planifikimit strategjik të Bashkisë Tiranë	Z. Redi Saliasi	Pergjegjes I PR dhe komunikimit prane kompanisë "Croën Agents"	Z. Elvin Nuriu	Drejtor i administratës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore / Aktivist i PDIU
Z. Erlis Hereni	Këshilltar ligjor pranë ministrit të Brendshëm / Drejtor ekzekutiv i "Aleancës së Rinisë Shqiptare"	Znj. Rikelda Balliu	Koordinatore e projektit të Bashkimit Evropian pranë drejtorisë së doganave	Znj. Erjona Rusi	Gazetare, Report TV
Z. Florjan Mucaj	Nënkryetar i Bashkisë Fier/ Aktivist i Partisë Socialiste	Znj. Vjollca Dako	Drejtoreshë ekzekutive e fondacionit mediatik "Dritan Hoxha"	Erton Graceni	Këshilltar për Teknologjinë pranë Këshillit të Ministrave
Z. Francesco Mucaj	Sekretar politik i forumit rinor të Partisë Socialiste	VITI 2015		Z. Ervis Mocka	Zv.dekan i Universitetit të Vlorës / Këshilltar i PS pranë Këshillit Bashkiak Vlorë
Znj. Ina Metko	Juriste, Ministria e Integrimit Evropian	Z. Admir Malaj	Këshilltar pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Znj. Evis Shurdha	Drejtoreshë e Administratës dhe Shërbimeve, Këshilli i Ministrave
Z. Juel Jarani	Zv.rektor në Universitetin e Sporteve	Znj. Amela Juka	P.administration / Political activist DP	Z. Fabian Zhilla	Kërkues mbi krimin e organizuar / Lektor pranë Institutit Kanadez të Teknologjisë
Znj. Juliana Cici	Zv.komisionere pranë "Avokatit të Popullit"	Znj. Arlinda Hoti	Drejtoreshë e trajnimeve, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	Znj. Gentiola Madhi	Kërkuese pranë organizatës Shtetiëeb
Z. Lulzim Omuri	Këshilltar i minibashkisë nr. 2, Tiranë / Aktivist i forumit rinor të Partisë Demokratike	Z. Artur Bardhi	Specialist pranë Dep. Të Integrimit, Ministria e Punëve të Jashtme / Aktivist i LSI	Znj. Irma Kopliku	Anëtare e Parlamentit / Lektore prane Universitetit të Shkodrës
Znj. Magi Apostoli	Koordinatore projekti pranë "Europartners Development"	Znj. Blerina Ago	Këshilltare e Ministrit të Drejtësisë	Znj. Jerina Vataj	Këshilltare e LSI pranë Këshillit Bashkiak Lezhë
Znj. Pranvera Myrselaj	Menaxhere financiare pranë "System Group Albania"	Znj. Dorina Puto	Eksperte ligjore pranë Institucionit të Presidentit të Republikës	Znj. Jolanda Mustafaraj	Këshilltare e PS pranë Këshillit Bashkiak Durrës

RRJETI ALUMNI 2007-2017



Znj. Lindita Pali	Këshilltare pranë Këshillit Bashkiak Burrel
Znj. Marsida Duli	Doktoreshë / Aktiviste e PD
Znj. Mirjeta Gjongecaj	Këshilltare e PD pranë Këshillit Bashkiak Bajram Curri
Z. Oljan Kanushi	Koordinator pranë Këshillit të Ministrave
Z. Sofjan Jaupaj	Këshilltar i Ministrit të Kulturës
Znj. Tresi Trebicka	Menaxhere programesh mbi zhvillimin e qëndrueshëm pranë "Eco Partners Albania"
Znj. Valbona Mucaj	Trajnuese pranë Shkollës Shqiptare e Administratës Publike
Znj. Zhanina Dapi	Drejtoreshë e drejtorisë së Integritetit, Ministria e Ekonomisë

VITI 2016

Znj. Albana Kraja	Shefe e njësive së përkthimit, Parlamenti Shqiptar
-------------------	--

Znj. Armela Mitku	Anëtare e Këshillit Drejtues të FRD / Specialiste pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Tiranë
Z. Besard Buzi	Ekspert vendor pranë Këshillit të Evropës
Z. Besfort Lamallari	Kërkues -Autor i raportit vjetor "Freedom House"
Znj. Brikena Hoxha	Asistente ekzekutive pranë bankës "Societe Generale Albania"
Znj. Eda Lika	Asistente ligjore, Zyra e Kryeministrit
Znj. Edlira Osmani	Kërkuese / Koordinatorë pranë misionit EURALIUS
Z. Eneo Zguri	Anëtar i Këshillit Kombëtar të PD
Z. Eraldo Khani	Këshilltar i grupit parlamentar të PS / Kreu i Dep. Cilësisë, Posta Shqiptare
Znj. Freskida Miloti	Producente dhe gazetare pranë Radio "Tirana"
Z. Indrit Puteci	Këshilltar i kryetarit të bashkisë Tiranës

Znj. Juliana Memaj	Kryetare e Bashkisë Ura Vajguore
Znj. Julinda Mansaku	Avokate pranë Avokaturës së Shtetit
Znj. Krisilda Fana	Shefe e dep. koordinimit me institucionet dhe HR, Presidenti i Republikës
Znj. Manjola Hidri	Eksperte e projekteve IPA pranë Ministrisë së Integritetit
Znj. Manushaqe Rina	Lektore në Univer. e Durrësit / Këshilltare bashkiake e PD-së, Dibër
Znj. Mina Skuqi	Juriste / Asistente e nënkryetarit të Parlamentit
Znj. Mirbana Bilali	Drejtoreshë ekzekutive e kompanisë "Security & Protection Group"
Znj. Olta Kepucka	Shefe e Burimeve Njerëzore dhe Financave, GIZ Shqiperi
Znj. Ornela Liperi	Kryeredaktore e revistës "Monitor"
Znj. Ramiola Kalemi	Lektore, pranë Univ. Durrës / Këshilltare bashkiake e PD-së, Durrës



Znj. Romira Muka	Lektore në Universitetin e Shkodrës / Këshilltare bashkiake e PD-së, Shkodër
Znj. Senida Mesi	Eksperte kontabël / Këshilltare bashkiake e PS-së, Shkodër
Z. Vaeld Zhezha	Këshilltar i ministrit të Mjedisit
Znj. Zamira Mustafaraj	Inxhinieri / Këshilltare bashkiake e PS-së, Durrës
Znj. Zarie Visha	Drejtoreshë shkolle / Këshilltare bashkiake e LSI-së, Kukës

VITI 2017

Znj. Adriana Hatellari	Mjeke / Anëtare e Këshillit Bashkiak Durres (LSI)
Z. Arber Kodra	Drejtor Ekzekutiv i Open Mind Spectrum Albania (OMSA)
Znj. Aurora Ndreu	Eksperte ligjore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë / Lektore pranë Akademisë Profesionale të Biznesit

Znj. Bora Muzhaqi	Konsulente e legjislacionit fiskal, "Ernst & Young Albania"
Znj. Brisela Kadija	Drejtoreshë Shkolle / Anëtare e Këshillit Bashkiak Shkodër (PS)
Z. Dritan Palnikaj	Këshilltar, Këshilli i Ministrave
Z. Enton Duro	Lektor, Universiteti i Tiranës / Këshilltar pranë ministrit të Financave
Znj. Enxhi Mero	Eksperte e dep. programeve ndërkufitare, Ministria e Integritimit
Z. Erion Cerekja	Kryetar i Dhomës së Tregëtisë Shqipëri -Turqi
Z. Erlis Hoxha	Drejtori i protokollit dhe arkivës Bashkia Tirane / Aktivist i PS
Znj. Ersida Teliti	Drejtoreshë e "Qendra e Konsumatorit" / Lektore, Universiteti i Tiranës
Z. Gjergj Prabibaj	Drejtor i Uzinës Mekanike, Bashkia Tiranë / Aktivist i PS
Z. Isuf Shehu	Themelues i Primis Law, Tax & Strategic Planning / Administrator, Advanced Systems & Technology shpk

Z. Ivi Bejtja	Sekretar i Forumit Rinor PD
Znj. Lindita Doda	Mësuese / Anëtare e Këshillit Bashkiak Mat (DP)
Znj. Lindita Shehu	Financiere / Anëtare e Këshillit Bashkiak Dibër (PDIU)
Znj. Lindita Sotiri	Këshilltare e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë
Znj. Lorisa Ylli	Koordinatorë, Qendra Shqiptare e Politikave / Aktiviste PD Durres
Znj. Minushe Lazaj	Sekretare e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Kuvendi Shqipërisë
Znj. Mona Xhexhaj	Kërkuese / Koordinatorë projekti pranë EMA
Z. Renato Demiraj	Specialist IT, Shkolla e Administratës Publike / Aktivist i PS
Z. Soljan Celibashi	Partner menaxhues, CC Law Office
Znj. Ujvara Ponari	Këshilltare diplomatike, Institucioni i Presidentit të Republikës
Znj. Zana Elezi	Mjeke / Kryetare e Këshillit Bashkiak Klos (PD)

ASP AKADEMIJA E STUDIMEVE POLITIKE PUBLIKIME



Tejkalimi i kompetencave ekzekutive në legjislacionin tatimor dhe mjedisor

Dokumenti analizon disa raste konkrete të "ndërrhyrjeve" të Këshillit të Ministrave si përfaqësues i pushtetit ekzekutiv apo edhe organeve të tjera përfaqësuese të pushtetit vendor në prodhimin e normave të reja, duke shkeluar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.



Qeverisja Vendore dhe gjithëpërfshirja e komunitetit LGBTI

Qëllimi kryesor i këtij punimi është vënia në dukje e përfshirjes dhe mbështetjes së komunitetit LGBTI, si një aspekt i vecantë i sistemit të mirëqeverisjes në qeverisjen vendore. Ofron një pasqyrim të realitetit shqiptar mbi aspekte të kompetencave dhe mundësisë të ushtrimit të tyre.



Impakti i reformës territoriale në kontekstin e zhvillimit të balancuar

Punimi synon të analizojë rezultatet buxhetore të Reformës Administrativo-Territoriale në vitin e parë të zbatimit të saj. Vlerësohet gjithashtu alokimi i fondeve në funksion të reduktimit të pabarazisë ekonomike midis qarqeve dhe përsheptimit të rritjes ekonomike të qëndrueshme.



Roli i kuotave gjinore në vendimmarrjen e Këshillave Bashkiakë

Ky punim analizon nismat e ndërmarra nga gratë e përfshira në politikën vendore. Sa është numri i nismave me ndikim social dhe sa janë implementuar ato në komunitet. Përmes tij, synohet të ofrohen rekomandime që do të ndikojnë në rritjen dhe fuqizimin e rolit të gruas në vendimmarrje.



Udhërrëfyesi rreth ekstremizmit të dhunshëm për mësuesit dhe prindërit

Ky udhërrëfyesi i përgatitur nga Akademia e Studimeve Politike synon të informojë të rinjtë, mësuesit dhe prindërit mbi ekstremizmin e dhunshëm si dhe të ofrojë disa këshilla për të krijuar rezistencën e duhur ndaj këtij rreziku. Ai është prodhuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian.



Studim mbi vlerësimin e nevojave për edukim dhe informim zgjedhor në Shqipëri - 2017

Studimi zhvillua nga Akademia e Studimeve Politike nëpërmjet një sondazhi me mbi 1.200 autoritete vendore, vëzhgues zgjedhore, minoritete etj. Gjetjet e këtij studimi shërbejnë për të kuptuar problematikën në informimin e votuesve si dhe administrimin nga trupa zgjedhore.

Akademia e Studimeve Politike

Kotoni Center,
Rr. Donika Kastrioti, Nr. 3,
Kati 4, Zyra 2
Tirane, Shqipëri


Tel/fax: +355 4 2272173
+355 4 4504788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al

Në rubrikën "Publikime" të faqes sonë www.asp.al mund të shkarkoni të gjitha botimet në versionin pdf.
Skanoni këtë kod për më tej QR CODE



- Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
- Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
- Akademia Studimeve Politike
- Akademia e Studimeve Politike

Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Ambasada e Zvicrës në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Ambasada e Zvicrës në Shqipëri